



SHALLJE PËR FURNIZIME DHE SHËRBIME

AKP e cila ka në Administrim të Drejtpërdrejtë Ndërmarrjen Shoqërore “Inex Sharr Planina ”
Brezovicë

SHALLË këtë:

FTESE PËR OFERTË

I. LËNDA E KONTRATËS

FURNIZIMI ME PIJE, USHQIM DHE MATERIAL SANITAR PËR NSH INEX SHARR PLANINA NË BREZOVICË

Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall ftesën për oferta për furnizimin e Nsh Inex Sharr Planina me ushqim, pije dhe material sanitar bazuar në listën e ushqimeve dhe mallrave të kërkuara. Specifikacioni i mallrave mund të merret në Web faqen e AKP-së ose te NSh Inex Sharr Planina në Brezovicë.

Çmimet janë për copë, kg, litër apo paketim varësisht nga kërkesat në listën e mallrave. Buxheti maksimal i paraparë për këtë aktivitet 100,000.00 Euro.

Kërkesat teknike për operatorin ekonomik:

Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës

Duhet të ketë përvojë në furnizime dhe shërbime të ngjashme – Referencat.

Periudha e furnizimit është 1 vjeçare varësisht nga kërkesat dhe nevojat e ndërmarrjes për këto mallra.

Operatori ekonomik fitues do të shpallet ai i cili i plotëson kriteret teknike dhe oferton me çmimin më të ulët.

AFATI KOHOR ,VENDI PËR DORËZIMIN E OFERTAVE DHE INFORMATAT TJERA

Për tu njohur më afër me aktivitetin që do të kryhen Operatorët ekonomik mund të bëjnë vizitë te Qendra e Skijimit në Brezovicë çdo ditë punë nga data **23.12.2023 deri më 03.01.2024** ku edhe mund të merren Informatat detale për furnizimet e mallrave.

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen më datën **04.01.2024** nga ora **13:15** deri në orën **14:15** në adresën e mëposhtme:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 Prishtinë.

Ofertat do të hapen me datën **04.01.2024** në ora **14:20** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 - Prishtinë.

V. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.